



**PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE TË NDËRMARRJES PUBLIKE BANESORE SH.A.**  
**2015/2016 NË RAPORT ME VITIN 2014**

	<i>Për fund vitin 31 Dhjetor 2014</i>	<i>Për fund vitin 31 Dhjetor 2015</i>	<i>Për fund vitin 31 Dhjetor 2016 (Vlerësim i Dhjetorit sipas trendit)</i>	<i>Krahasimi 15/14</i>	<i>Krahasimi 16/14</i>
Të hyrat operative	1,136,326	1,391,363	1,381,616	122%	122%
Total shpenzimet operative	1,133,835	1,099,771	1,092,284	97%	96%
Fitimi/Humbja nga operimet	2,491	291,592	289,332	11706%	11615%
Numri i punëtorëve	74	88	91		
Marzha e fitimit Neto	0.22%	20.96%	20.94%		
Rentabiliteti për punëtorë	33.66	3,313.55	3,179.47		
Shpenzimet për punëtorë	15,322.09	12,497.40	12,003.12		

Pasqyra e performancës financiare e paraqitur në formë tabelare ka për qëllim informimin e palëve të interesuara për performancën financiare të Ndërmarrjes Publike Banesore SH.A. në 3 vitet e fundit.

Duke analizuar zërat kyç të kësaj table të paraqitur, ne mund të konkludojmë që performanca e NPB-së ndër vite është përmirësuar dukshëm dhe trendi i rritjes së mëturtyeshme është shumë i favorshëm për zhvillimin e Ndërmarrjes Publike Banesore.

Mëposhtë janë të paraqitura në formë tekstuale krahasimet e treguesve të paraqitur në tabelën e mësipërme:

- Të hyrat operative në vitin 2015 në raport me vitin 2014 janë rritur për 22%, ndërsa rritja ka vazhduar edhe në vitin 2016 ku në raport me vitin 2014 kemi një rritje në vazhdimësi prej 22%.



**NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SH.A.**  
**PUBLIC HOUSING ENTERPRISE J.S.C.**

Adr: Rr. Bill Klinton pn. Prishtinë-Kosovë  
Tel: +381(0)38 553 311/523 001; Fax: +381 (0)38 522 446  
e-mail: npb@npbanesore.com web: www.npbanesore.com

---

- Shpenzimet operative në vitin 2015 në raport me vitin 2014 janë zvogëluar për 3 % përkundër rritjes së kapaciteve operative të NPB-së. Ndërsa në vitin 2016 në raport me vitin 2014, shpenzimet operative kanë pësuar rënie të ndjeshme prej 4 %, mirëpo në krahasim me ngritjen e kapaciteve të reja dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të NPB-së, kjo rënie paraqet menaxhim efikas të shpenzimeve.
- Fitimi neto në vitin 2015 në raport me vitin 2014 është rritur me mbi 287,000 € me shumë dhe kjo rritje stabile ka vazhduar edhe në vitin 2016 ku ka arritur vlerën prej 289,332 €.
- Rentabiliteti për punëtorë nga 33.66 € sa ka qenë në vitin 2014 është ngritur në 3,313 € në vitin 2015 dhe përkundër rritjes së kapaciteteve operative të NPB-së, rentabiliteti për punëtorë ka qenë i lartë edhe në vitin 2016 në shumë prej 3,179 €. Ky indikator na e paraqet produktivitetin e punëtorëve krahas ngritjes së të hyrave operative.
- Shpenzimet për punëtorë nga viti në vit kanë pësuar rënie. Duke filluar nga viti 2014 që kanë qenë 15,322 € kanë arritur nivelin prej 12,003 € në vitin 2016.

Si përfundim, me të dhënat e paraqitura në tabelë dhe planifikimet biznesore, Ndërmarrja Publike Banesore do të vazhdoj rritjen e të hyrave operative dhe do të realizoj menaxhim të shpenzimeve në mënyrë sa më efektive në raport me rritjen dhe zhvillimin e saj.